



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.64

2004

10 shtator

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4305 datë 8.9.2004	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	4027
Vendim i KM nr.560, datë 27.8.2004	Për përcaktimin e disa kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike	4027
Vendim i KM nr.561, datë 27.8.2004	Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës "ROT", ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë, si Organ Shtetëror i Autorizuar, dhe "Yilmaz Kablo", S.A.S, për uzinën e telave dhe të kablllove, Shkodër	4030
Vendim i KM nr.563, datë 27.8.2004	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.170, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre"	4041
Vendim i KM nr.564, datë 27.8.2004	Për vlerësimin e automjeteve të parkut të transportit të mineralit, Bulqizë dhe të automjeteve të uzinës së ferrokromit, Burrel.....	4042

Vendim i KM nr.567, datë 27.8.2004	Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë"	4044
Vendim i KM nr.570, datë 27.8.2004	Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit të disa parcelave pyjore, pjesë të ekonomisë pyjore Gjadër-Mnelë, Shkodër, nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një shtesë në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes"	4045
Vendim i KM nr.571, datë 27.8.2004	Për miratimin e kuotës së pranimit të studentëve në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari", për vitin akademik 2004-2005.....	4046
Vendim i KM nr.573, datë 27.8.2004	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Malit të Zi, për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave.....	4047
Vendim i KKRT nr.256, datë 31.8.2004	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat "DCN"	4053
Vendim i KKRT nr.257, datë 31.8.2004	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat "INKUSAT"...	4054
Vendim i KKRT nr.258, datë 31.8.2004	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat "HB-CATV"..	4055

DEKRET
Nr.4305, datë 8.9.2004

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të nenit 20 dhe nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare",

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të saj:
Agnesë Muhamet Vuthaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.560, datë 27.8.2004

**PËR PËRCAKTIMIN E DISA KUSHTEVE LEHTËSUESE PËR NDËRTIMIN E BURIMEVE
TË REJA TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2,3 e 5 të ligjit nr.8987, datë 24.12.2002 "Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personi juridik, vendas ose i huaj, i cili ndërton burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, që përdorin lëndë djegëse të lëngëta ose të ngurta dhe pa kufizim për burime të tjera të rinovueshme të prodhimit, pasi të ketë marrë nga organet shtetërore përkatëse lejen për ndërtimin e një objekti gjenerues në përputhje me legjislacionin në fuqi, duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, 6 muaj para fillimit të importimit, listën e plotë e të specifikuar të makinerive dhe pajisjeve që do të importohen vetëm për këtë objekt.

Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës e miraton këtë listë pas shqyrtimit dhe verifikimit të saj.

2. Lista e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi duhet të përmbajë për çdo makineri dhe pajisje që importohet, këto specifikime:

- emërtimin dhe shenjat e njësive së makinerisë/pajisjes;
- karakteristikat kryesore teknike të makinerisë/pajisjes, sasinë dhe çmimin e blerjes;
- specifikime të tjera sqaruese (konsumi specifik i burimit etj.).

3. Lista e miratuar nga Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës mbahet në pesë kopje, nga të cilat: një kopje i dërgohet subjektit investitor të licencuar, një kopje Ministrisë së Financave, një kopje Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, një kopje Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe një kopje ruhet në Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pas paraqitjes së kërkesës nga subjekti investitor, zbaton të gjitha procedurat e parashikuara nga legjislacioni doganor për përjashtimin e makinerive dhe të pajisjeve të përfshira në listë nga taksat doganore.

5. Për çdo ndryshim në listën e specifikuar të makinerive dhe pajisjeve që importohen, institucionet e përmendura në pikën 3, veprojnë në përputhje me dokumentet zyrtare që kërkojnë ndryshimin dhe për këtë japin miratimin përkatës. Në rast se në listën e miratuar më parë është përfshirë një makineri/pajisje, që nuk i takon këtij objekti, veprimet doganore kryhen vetëm pasi të shlyhet dhe dokumentohet pagesa e taksës doganore, e cila nuk ishte paguar në zbatim të këtij vendimi.

6. Energjia elektrike e shitur, që prodhohet nga burimet, sipas përcaktimit të pikës 1, matet nëpërmjet matësit të energjisë elektrike, i cili administrohet dhe kontrollohet bashkërisht nga prodhuesi dhe blerësi.

Sasia e energjisë elektrike të shitur apo prodhuar të vlerësohet çdo muaj si diferencë e leximeve të matësit në fund dhe në fillim të muajit.

Sasia e energjisë elektrike, që u shitet të tretëve, matet në kWh/muaj dhe deklarohet në faturën e përbashkët të mbajtur ndërmjet shitësit dhe blerësit, ndërsa sasia e energjisë së prodhuar deklarohet nga prodhuesi, sipas vlerës së treguar në matësin e vendosur në dalje të gjeneratorit elektrik.

7. Për subjektet që prodhojnë energji elektrike kryesisht për nevojat e veta (vetëprodhuesit), energjia elektrike e shitur nënkupton energjinë e prodhuar dhe të matur nga matësi i gjeneratorëve elektrikë.

8. Konsumi specifik i lëndës djegëse në burim është sasia e lëndës djegëse të përdorur për prodhimin e 1 kWh energji elektrike. Në këtë vlerë përfshihet edhe sasia e lëndës djegëse, që konsumohet për nevojat e centralit elektrik.

9. Sasia e lëndës djegëse të konsumuar, që do të rimbursohet, llogaritet si produkt i sasisë së energjisë elektrike të shitur apo të prodhuar, me konsumin specifik të lëndës djegëse të llogaritur sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Për llogaritjen e sasisë së lëndës djegëse të rimbursuar, si vlerë e konsumit specifik, kur kjo vlerë është më e vogël se vlera përkatëse e tabelës nr.1 të përmendur në pikën 9 të këtij vendimi, të përdoret vlera e deklaruar nga subjekti, sipas pikës 2 të këtij vendimi.

Për llogaritjen e sasisë së lëndës djegëse të rimbursuar, kur vlera e konsumit specifik të deklaruar është më e madhe se vlera përkatëse, sipas tabelës nr.1 të përdoret vlera e dhënë në këtë tabelë, në funksion të llojit të lëndës djegëse dhe të teknologjisë që përdoret.

Për llogaritjen e sasisë së lëndës djegëse të rimbursuar, për çdo vit amortizimi të burimit, vlera e konsumit specifik të lëndës djegëse rritet me një normë 1 për qind, kur burimi punon me lëndë djegëse gaz natyror, 1.15 për qind, kur punon me lëndë djegëse diesel, 1.3 për qind, kur punon me lëndë djegëse solar, 1.45 për qind, kur punon me lëndë djegëse mazut, dhe 1.60 për qind, kur punon me lëndë djegëse qymyr.

11. Vlera e rimbursimit të sasisë së lëndës djegëse të konsumuar (Vr lekë/muaj) për energjinë elektrike të shitur apo prodhuar, bazohet në sasinë e shitur apo të prodhuar të energjisë elektrike, në konsumin specifik, në vlerën doganore të importit të lëndës djegëse përkatëse, si dhe në rimbursimin e plotë të taksës doganore e akcizës dhe llogaritet sipas formulës së paraqitur në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Rimbursimi i kundërvlerës së taksës doganore e i akcizës për lëndën djegëse të konsumuar, të llogaritur sipas formulës, të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për çdo muaj, nga llogaria e veçantë buxhetore e krijuar nga kjo drejtori për këtë qëllim dhe jo më vonë se 45 ditë nga data e kryerjes së veprimeve në doganë.

13. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

14. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Tabela nr.1

Tabela 1. Vlerat e pranura të konsumit specifik në funksion të teknologjisë dhe lëndëve djegëse të përdorura në burimet e energjisë elektrike					
Lënda djegëse	Motor diesel (DM)	Turbinë me gaz (GT)	Turbinë me avull (ST)	Cikël i kombinuar (CCGT)	Qu [kJ/m ³ N, kg]
Gaz natyror [m ³ N/k Wh]	0.2297	0.2421	0.2560	0.1792	40186
Diezel [gram/k Wh]	232.4	245.7	252.9	179.2	41860
Solar [gram/k Wh]	251.0		270.1		40395
Mazut [gram/k Wh]			292.1		38511
Qymyr [gram/k Wh]			770.6		15070

SHTOJCA Nr.1

FORMULA E LLOGARITJES SË VLERËS QË DO TË RIMBURSOHET

$$V_r = P_{el} * N_t * V_{ld} / 100 * (A \% + D \% + A \% * D \%)$$

ku:

V_r-Vlera e rimbursimit të sasisë së lëndës djegëse për energjinë elektrike të shitur apo prodhuar (lekë/muaj)

P_{el}-Energjia elektrike e shitur apo prodhuar, sipas pikave 6 e 7 të këtij vendimi (kWh/muaj).

N_t-Konsumi specifik i lëndës djegëse për prodhimin e energjisë elektrike (gram,m³ N/kWh).

V_{ld}-Vlera doganore e mallit, lëndës djegëse sipas deklaratës doganore përkatëse.

A %-Taksa e akcizës e shprehur me përqindje, sipas llojit të lëndës djegëse dhe e përcaktuar sipas ligjit nr.8437, datë 28.12.1998 "Për akcizat".

D %-Taksa doganore e shprehur në përqindje, sipas llojit të lëndës djegëse dhe e përcaktuar sipas ligjit nr.8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifave doganore".

VENDIM
Nr.561, datë 27.8.2004

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS "ROT",
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E INDUSTRISË DHE E ENERGJETIKËS DHE
MINISTRIA E EKONOMISË, SI ORGAN SHTETËROR I AUTORIZUAR, DHE "YILMAZ
KABLO", S.A.S, PËR UZINËN E TELAVE DHE TË KABLLOVE, SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 9 e 10 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës "ROT", të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë, si Organ Shtetëror i Autorizuar (OSHA), dhe "Yilmaz Kablo", S.A.S, për uzinën e telave dhe të kabllove, Shkodër, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës dhe Ministri i Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE KONCESIONI

Marrëveshje koncesioni e lidhur midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga OSHA "Organi Shtetëror i Autorizuar" (vendimi i Këshillit të Ministrave nr.592, datë 28.8.2003), Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Leonard Tako me autorizimin me nr.4552/5, datë 2.9.2004 të Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe Z.Stefan Koçollari me autorizimin nr.5107/3, datë 24.8.2004 të Ministrisë së Ekonomisë;

dhe "YILMAZ-KABLO" S.A.S. kompania e së drejtës turke, e emërtuar "Yilmaz Kablo" S.A.S me seli në Bankalar Cad. nr.21 Karakoy Istanbul, Turqi, e përfaqësuar ligjërisht për negocimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje nga Ismail Altay Mehmet Halazaogly në bazë të prokurës së lëshuar më datë 27.2.2002 nga Ismail Altay Mehmet Halazaogly në cilësinë e presidentit të kompanisë "Yilmaz Kablo" S.A.S.

Duke pasur parasysh që:

- Në kuadrin e zhvillimit ekonomik të vendit, Qeveria shqiptare i ka dhënë një rol prioritar zhvillimit dhe ristrukturimit të zonave industriale;

- Legjislacioni në fuqi rregullon dhënien me koncesion të objekteve industriale dhe me vendim të Këshillit të Ministrave nr.522, datë 25.8.2003 "Për dhënien me koncesion të uzinës së telave dhe kabllove në Shkodër dhe për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit të ofertave për marrjen me koncesion të këtij objekti" autorizohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së koncesionit;

- Shoqëria "YILMAZ-KABLO" S.A.S. është e interesuar të investojë në uzinën e telave e kallove në Shkodër dhe sipas propozimit që do të paraqesë dhe në URB Rubik, me qëllim realizimin e ristrukturimit gradual të këtyre uzinave për prodhimin e telave e kabllove të bakrit të rafinuar dhe aliazheve të tij, për treg të brendshëm e të jashtëm;

- Shoqëria “YILMAZ-KABLO” S.A.S. zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj marrëveshjeje;

Palët bien dakord që të bashkëpunojnë për rehabilitimin e uzinës së prodhimit të telave e kabllave Shkodër, me koncesion të formës “ROT” (rehabilitim-shfrytëzim-transferim), sipas planbiznesit të paraqitur dhe kushteve të mëposhtme.

Neni 1 **Përkufizime**

Kudo që në këtë marrëveshje përdoren termit e mëposhtëm, do të kenë kuptimet përkatëse të mëposhtme:

- Marrëveshje koncesioni: Dokumenti në fjalë dhe anekset e tij.
- Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA): Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë.

- Koncesionari: “YILMAZ-KABLO” S.A.S.
- Kontratat: Të gjitha kontratat e nënshkruara nga koncesionari me sipërmarrësit për realizimin e punimeve.

Sipërmarrës: Të gjithë nënkontraktorët dhe furnizuesit, që do të kryejnë shërbimet e nevojshme për zbatimin e projektit.

- Ndryshim i ligjit: Do të thotë çdo akt ligjor i miratuar nga organet kompetente të Republikës së Shqipërisë, që ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje koncesioni.

- Projekti: Studimi tekniko-ekonomik për rehabilitimin e uzinës së telave e kabllave në Shkodër.

- Tërësi fizike: Nënkuptohen të gjitha rikonstruktionet dhe ndërtimet sipas projektit për të realizuar qëllimin e koncesionit.

- Anekset: Aneksi 1: Sipërfaqet dhe objektet që jepen me koncesion;
Aneksi 2: Plani i investimeve;
Aneksi 3: Lista e fuqisë punëtore, që do të mbahet në punë.

Neni 2 **Objekti i koncesionit**

Objekti i kësaj marrëveshjeje është:

- Dhënia me koncesion e uzinës së telave e kabllave në Shkodër.
- Rehabilitim, ristrukturim në parametrat, sipas planbiznesit të paraqitur, të tërësisë fizike dhe teknologjike të objektit.

- Operim optimal tekniko-ekonomik për prodhimin e telave dhe të kabllave.

- Transferim shtetit të aseteve, makinerive e pajisjeve të ristrukturuara të objekteve, të cilat janë në gjendje pune në përfundim të periudhës së koncesionit.

Neni 3 **Kriteret specifike të punimeve**

Plani i rehabilitimit do të realizohet për një periudhë maksimale 60 muaj, që ndahet në tre faza.

Faza e parë

Kompletimi i linjës teknologjike, rehabilitimi i makinerive dhe pajisjeve dhe vënia në punë e linjës, me vlerë totale 1 (një) milionë USD.

Investimet do të kryhen në një periudhë 2 (dy) vjeçare; në vitin e parë 0.4 milionë USD dhe në vitin e dytë 0.6 milionë USD.

Faza e dytë

Investimet do të kryhen për linjën e derdhjes së pandërprerë tip Otokumpu në vitin e tretë e të katërt të koncesionit me vlerë 5.5 (pesë e gjysëm) milionë USD.

Gjatë kësaj faze do të kryhet studimi për shtimin e gamës së prodhimeve të telave e kabllove dhe për automatizimin e procesit.

Faza e tretë

Investimet do të kryhen në ndërtimin e linjave të reja, për zgjerimin e nomenklaturës së prodhimeve të uzinës me tregues cilësorë, sipas standardeve ndërkombëtare.

Investimet në këtë fazë do të kryhen në vitin e pestë të koncesionit, me vlerë 3.5 (tre e gjysëm) milionë USD.

Fazat e kryerjes së rehabilitimit mund të realizohen edhe të ndërthurura në kohë me njëra-tjetrën.

Investimi i përgjithshëm i realizimit të projektit është 10 (dhjetë) milionë USD. Aneksi 2, pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje, i përket punimeve që do të kryhen respektivisht në 3 fazat e parashikuara më lart.

Neni 4 **Dorëzimi i objektit**

Dorëzimi i objektit të përfundojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes së koncesionit.

Dorëzimi do të bëhet me procesverbal të firmosur nga të dyja palët, i cili do të përmbajë të përshkruar inventarin e objekteve ndërtimore, shesheve, makinerive e pajisjeve, mjetet e xhiros (me përjashtim të likuiditeteve), si dhe gjendjen e tyre aktuale. Pjesë e këtij inventari do të jetë edhe arkiva teknike e uzinës së telave dhe të kabllove. Akti i dorëzimit është pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

Neni 5 **Fillimi i prodhimit**

Koncesionari duhet të fillojë prodhimin brenda 6(gjashtë) muajve, pas marrjes në dorëzim të objektit.

Neni 6 **Detyrimet dhe të drejtat e koncesionarit**

Koncesionari brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga nënshkrimi i marrëveshjes së koncesionit do të formojë shoqërinë koncesionare, sipas të drejtës shqiptare. Shoqëria do të jetë shoqëri tregtare dhe do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.

- Koncesionari merr përsipër realizimin e objektit të marrëveshjes së koncesionit, sipas planit të ristrukturimit, të përcaktuar në nenin 3 dhe aneksin 2 bashkëlidhur.

- Koncesionari merr përsipër për realizimin e projektit të mbajë në punë fuqinë punëtore ekzistuese, sipas listëpagesës së punonjësve deri në datën 30.6.2004 dhe ta rrisë atë sipas fazave të paraqitura gjatë realizimit të projektit të tij.

- Koncesionari nuk përgjigjet për detyrimet që uzina e prodhimit të telave dhe kabllove ka me të tretët, para datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

Koncesionari detyrohet:

- të zbatojë punimet, në përputhje me projektin e investimeve, sipas parashikimeve të nenit 3;

- të sigurojë drejtimin e punimeve, duke mbajtur në informim të vazhdueshëm OSHA-në, për realizimin e tyre;

- ta administrojë projektin për periudhën e koncesionit dhe të respektojë të drejtën e OSHA-së për ruajtjen e pronësisë mbi objektet dhe mjetet kryesore, të dhëna me koncesion;

- të paguajë të gjitha detyrimet tatimore, që rrjedhin nga aktiviteti ekonomik dhe taksat, që rëndojnë mbi pronën, sipas legjislacionit në fuqi;

- të deklarojë dhe kontabilizojë të gjitha asetet, që do të shtohen gjatë periudhës së koncesionit; të zbatojë Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore, që lidhen me marrëdhëniet punëmarrës-punëdhënës dhe të sigurimit teknik;

- të zbatojë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë;

- të paraqesë, mbështetur në planbiznesin e dorëzuar, 10 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, studimin për marrjen me koncesion të uzinës së rafinimit të bakrit në Rubik; Mosplotësimi i kësaj detyre përbën kusht për prishjen e kësaj marrëveshjeje.

- të vendosë garancitë për çdo fazë, në masën 10(dhjetë) % të investimeve. Garancia do të vendoset veç e veç në fillim të zbatimit të çdo faze, në përputhje me investimet e paraqitura në nenin 3 dhe aneksin 2 të kësaj marrëveshjeje (garancia në fazën e parë 100 000 USD, në fazën e dytë 550 000 USD dhe në fazën e tretë 350 000 USD).

Koncesionari ka të drejtë:

- Referuar nenit 12 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995, palët të ndërgjegjshme për të siguruar një zhvillim të mirëbalancuar të qendrave industriale në Shqipëri dhe për të mbrojtur në mënyrën e duhur investimin dhe veprimtarinë e koncesionarit, bien dakord që koncesionari për një periudhë prej 7 vjetësh, ka të drejtë të jetë i vetmi entitet ligjor i pajisur me të drejtën për të prodhuar tela dhe kabllo në vend.

Neni 7

Detyrimet e OSHA-së

OSHA-ja merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- T'i dorëzojë koncesionarit objektin e koncesionit, sipas aktit të dorëzimit, të hartuar nga palët;

- Të pajisë shoqërinë koncesionare me lejen për ushtrimin e aktivitetit për prodhimin e kabllove dhe telave, brenda afateve ligjore;

- Me kërkesën e koncesionarit asiston për të marrë masat e nevojshme për organizimin e ruajtjes dhe të sigurimit të zonës.

- Me kërkesën e koncesionarit mund të ndihmojë në nxjerrjen e autorizimeve urbanistike, lejeve të ndërtimit, lejeve të nevojshme të punimeve për realizimin e projektit.

- Të asistojë koncesionarin pranë çdo organizmi shtetëror të pushtetit të qeverisjes vendore, enti e autoriteti shqiptar, për realizimin e qëllimit të koncesionit sipas planbiznesit.

- Të çlirojë garancinë e investimeve në përfundim të çdo faze nëse ato janë realizuar sipas nenit 3 dhe aneksit 2 të marrëveshjes dhe është firmosur nga palët akti i vlerësimit të investimeve të kryera.

Neni 8

Vlerësimi i investimeve

Në bazë të planit të rehabilitimit bashkëlidhur, vlefata e punimeve vlerësohet të jetë 10 (dhjetë) milionë USD.

Vlefata e paraqitur më lart mund të pësojë ndryshime në përputhje me tregun, pa ndryshuar zërat e investimit, që janë parashikuar në nenin 3 për realizimin e projektit.

Koncesionari do t'i paraqesë OSHA-së faturat e blerjeve dhe shpenzimeve të tjera sipas planbiznesit, për të justifikuar vlerat e investuara.

Në fund të çdo faze investimi, palët bëjnë vlerësimin dhe hartojnë një akt, të firmosur prej tyre dhe që bëhet pjesë e kësaj marrëveshjeje.

Neni 9

Periudha e koncesionit

OSHA-ja i jep koncesionarit me koncesion uzinën e telave dhe të kabllove në Shkodër, për

një periudhë 30-vjeçare. Kjo periudhë do të fillojë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Bazuar në ligjin nr.7973, datë 26.7.1995, pika 4 e nenit 11, koncesionari ka të drejtë të përdorë si garanci pasuritë e shoqërisë, me kusht që ato të vazhdojnë të shfrytëzohen për të përmbushur objektivat e kontratës së koncesionit.

Neni 10

Programi i punimeve

Koncesionari detyrohet të respektojë programin e parashikuar në planin e ristrukturimit dhe të punimeve përkatëse, siç është parashikuar në nenin 3 dhe aneksin 2.

Koncesionari garanton të zbatojë investimet e parashikuara në planin e rehabilitimit, me qëllim që të realizojë objektin e koncesionit. Projekti do të realizohet sipas specifikimeve të shprehura në aneksin 2 bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje edhe planbiznesit përkatës, të cilat janë pjesë integrale të saj.

Për sipërfaqet që mund të dalin të lira si rezultat i realizimit të projektit, koncesionarit i lind e drejta që, në marrëveshje midis palëve, t'i përdorë ato duke investuar edhe për qëllime të tjera, por brenda objektit të kësaj marrëveshjeje ose ia kthen OSHA-së.

Neni 11

Zgjidhja e marrëveshjes së koncesionit

OSHA-ja mund të zgjidhë marrëveshjen e koncesionit kur konstaton shkelje të vazhdueshme të detyrimeve të marra nga koncesionari, të tilla që kompromentojnë vazhdimësinë e punimeve të parashikuara në planin e ristrukturimit. Në rast se ngjarje të tilla verifikohen, OSHA-ja duhet t'i komunikojë koncesionarit shkeljet, duke pritur 30 (tridhjetë) ditë për një përgjigje shpjeguese.

Në rast se kontrata zgjidhet për shkaqet e mësipërme dhe në qoftë se koncesionari largohet në mënyrë të njëanshme, para përfundimit të marrëveshjes, investimet e kryera i mbeten shtetit shqiptar.

Neni 12

Kontratat

Koncesionari ka të drejtë të përdorë nënkontraktorë për realizimin e projektit.

Për të gjitha kontratat që koncesionari do të lidhë me të tretët, ai duhet të respektojë ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje.

Koncesionari do të jetë përgjegjësi i vetëm kundrejt OSHA-së për zbatimin e përpiktë të projektit, pavarësisht nga kontratat që do të lidhen me të tretët.

OSHA-ja nuk ka asnjë detyrim kundrejt të tretëve, që lidhen me koncesionarin dhe me këtë marrëveshje.

Neni 13

Sigurimi, riparimi dhe mirëmbajtja

Koncesionari do të bëjë sigurimin e objekteve të dhëna me koncesion, përsa i përket rrezikut kundër zjarrit, dëmtimeve dhe vjedhjeve, riparimin e mirëmbajtjen e ndërtesave dhe strukurave të paluajtshme të zonës së ristrukturuar për periudhën e koncesionit.

Koncesionari pajis OSHA-në me kopjet e dokumentacionet përkatëse për sigurimet e bëra. Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet ose dëmtohet për shkak të rreziqeve për të cilat është siguruar, zhdëmtimet në para të marra nga koncesionari për këtë qëllim do të përdoren për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen funksionuese në parametrat e projektit.

Neni 14

Kontrolli dhe inspektimi

OSHA-ja ka të drejtë dhe detyrë të kontrollojë rregullisht ecurinë e marrëveshjes, sipas kushteve të miratuara në këtë kontratë.

Koncesionari dhe OSHA-ja përcaktojnë mënyrën e përshtatshme të kontrollit, duke qenë dakord që kjo veprimtari të mos përbëjë ndërhyrje të paarsyeshme në zbatimin e projektit. Koncesionari do të japë çdo sqarim teknik të kërkuar.

Në çdo rast, kur OSHA-ja konstaton parregullsi, do t'ia komunikojë me shkrim vërejtjet koncesionarit, duke kërkuar të vazhdojë punimet sipas aneksit 2 të kësaj marrëveshjeje koncesioni.

Neni 15

Legjislacioni që do t'i referohet

OSHA-ja garanton se gjithçka që është vendosur në marrëveshjen në fjalë nuk mund të ndryshohet nga aktet ligjore dhe nënligjore, që hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

Ligji i aplikueshëm do të jetë ai shqiptar.

Neni 16

Forca madhore

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore: katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, gjendja e luftës, që kanë fuqinë e ligjit dhe çdo ngjarje e barabartë që mund të ndikojë në objektin e kësaj marrëveshjeje, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të marrëveshjes, që kanë të bëjnë me vullnetin e palëve.

Gjatë zbatimit të marrëveshjes, në rast se verifikohen ngjarje të forcës madhore, vonesa të mundshme ose mosrespektim të detyrimeve të palëve, ato nuk mund të jenë motiv për kërkesa reciproke për zhdëmtim.

Në këtë rast, kur një detyrim i kësaj marrëveshjeje nuk përmbushet ose do të hiqet si rezultat i forcës madhore, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim palën tjetër, duke i treguar dhe duke arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat. OSHA-ja ka të drejtën t'i verifikojë ato.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve, do të konfirmohen nga palët në një procesverbal të ngjarjes rast pas rasti.

Për dëme dhe vonesa të shkaktuara për faj të të tretëve, të cilat nuk janë forca madhore dhe nuk varen nga koncesionari, por që pengojnë realizimin në afat të marrëveshjes, atëherë me mirëkuptim midis dy palëve mund të rishikohen afatet e saj.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kjo marrëveshje koncesioni do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me të drejtën zvicerane. Të gjitha mosmarrëveshjet që do të dalin ose rrjedhin nga kjo marrëveshje koncesioni, të cilat nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim nga përfaqësuesit e palëve (në kuptim të këtij neni përfaqësuesi i shtetit shqiptar do të jetë Ministri i Ekonomisë dhe për shoqërinë "Yilmaz-Kablo" S.A.S. do të jetë drejtori i përgjithshëm) gjatë dy takimeve, të cilat do të zhvillohen brenda një periudhe jo më të gjatë se 60 ditë që nga dita e paraqitjes me shkrim të kërkesës nga njëra prej palëve, do të trajtohen dhe zgjidhen nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar (siç parashikohet në nenin 17 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995) në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, nga një ose me shumë arbitra të caktuar në përputhje me rregullat e sipërpërmendura.

Vendi i arbitrazhit do të jetë në Zyrë.

Gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

Vendimi i dhënë nga arbitri do të jetë përfundimtar dhe me fuqi detyruese për palët.

Neni 18
Sanksionet

Në rast se për faj të koncesionarit do të konstatohen shkelje të afateve të përcaktuara në nenin 3, do t'i lihet e drejta koncesionarit që t'i realizojë ato brenda fazës pasardhëse, brenda 3 muajve, ndërsa për fazën e fundit brenda 6 (gjashtë) muajve nga afati i përfundimit. Në rast mos realizimi edhe në këto afate, koncesionari do t'i paguajë OSHA-së penaltetin 0.01% në ditë të vlerës së investimit të përealizuar në faza.

Neni 19
Bashkëpunimi

OSHA-ja dhe koncesionari angazhohen reciprokisht për të bashkëpunuar dhe kooperuar ndërmjet tyre, me qëllim që të garantohet realizimi optimal i projektit. Korrespondenca midis palëve do të dërgohet në adresat respektive.

Neni 20
Dispozita përmbyllëse

OSHA-ja dhe koncesionari do t'i komunikojnë njëri-tjetrit emrin e të ngarkuarit për të firmosur aktin në fjalë, si dhe anekset bashkëlidhur, që do të hartohen në gjuhën shqipe dhe angleze, në gjashtë kopje origjinale, për secilën gjuhë.

Neni 21
Regjistrimi i pasurisë

Koncesionari, 30 (tridhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, detyrohet të depozitojë këtë marrëveshje koncesionare në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Shkodër.

Neni 22
Hyrja në fuqi e marrëveshjes

Marrëveshja në fjalë, si dhe anekset bashkëlidhur, që janë pjesë integrale e saj, do të hyjnë në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe pasi të jetë miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995.

PËR OSHA-në
Grupi i negocimit

PËR “YILMAZ-KABLO” S.A.S
Ismail Altay Halazaogly

ANEKSI NR.1

SIPËRFAQET DHE OBJEKTET QË JEPEN ME KONCESION

I. Planimetria e uzinës së telave e kablllove, Shkodër

a) Sipërfaqet

Sipërfaqja e ndërtimeve (objektet)	40 712 m ²
Sipërfaqja e rrugëve dhe kalimeve	14 822 m ²
Sipërfaqja e lirë (lulishte=trotuare)	<u>29 466 m²</u>
Sipërfaqja e përgjithshme	85 000 m ²

b) Kufizimet

Nga veriu-subjekt privat, rrobaqepsia "Shqipëria Trikot"

Nga jugu-shkolla e mesme industriale "Arben Broci", reparti i ndërhyrjes së shpejtë nr.731

Nga lindja-rruga Spital-Fermentim

Nga perëndimi-rruga Rusi-Fermentim

II. Objektet e uzinës së telave dhe kablllove, Shkodër

Nr.	EMËRTIMI
1.	Porteria e vjetër
2	Administrata
3	Mensa + kuzhina
4	Reparti i zmalimit
5	Reparti i telëzimit (dhe n/stacioni elektrik)
6	Reparti i telëzimit shtesë
7	Reparti i PVC-së
7/1	Shesh depozitimi materiali
8	Magazina 3-katëshe
8/1	Shtesa magazina 3-katëshe + vend roje
9	Magazina tetoje
10	Vendstrehime
11	Reparti i ri i bobinave
12	Reparti i vjetër i bobinave
13	Kapanoni i ruajtjes së arkave
14	Kapanone qymyri
15	Kaldaja e re
16	Kaldaja e vjetër
17	Reparti i oficinës + sipërfaqe nën vinç
17/1	Shesh depozitimi materiali
18	Reparti i oficinës shtesë
19	Reparti i petëzimit + sipërfaqe nën vinç
19/1	Shesh depozitimi materiali
20	Peshore 15-tonëshe
21	Magazina e lëndëve djegëse
22	Rezervuar mazuti
23	Reparti i linjave të reja + kapanon
24	Pishina
25	Stacioni i pompave
26	Depo oksigjeni
27	Reparti i fonderisë

28	Reparti i kablllove
29	Ndërtesa të demoluara (2 copë)
30	Reparti i ri i kablllove + n/stacioni elektrik
31	Reparti i barabaneve
32	Reparti i ri i barabaneve
33	Reparti i ri i telëzimit + n/stacioni elektrik
34	Magazina qendrore e re
35	Magazina e produktit të gatshëm
36	Reparti i zmalimit "Magu"
36/1	Shesh depozitimi materiale
37	Reparti i kompresorit, i papërfunduar
38	Reparti i ri i ambalazhit, i papërfunduar
39	Reparti i zmalimit vertikal, i papërfunduar
40	Shesh betoni i vinçit "Cap"
41	Rezervuar (2 copë)
42	Porteria e re

Shënim. Bashkëlidhur paraqesim genplanin e uzinës së telave e kablllove, Shkodër

ANEKSI NR.2

PROGRAMI I INVESTIMEVE

Faza e parë

Periudha e fillimit deri në gjashtë muaj

1. Kontrolli dhe vlerësimi i detajuar i gjendjes teknike të ndërtesave dhe hartimi i projektit të rikonstruksionit të tyre
2. Vlerësimi i gjendjes teknike të linjave të telëzimit dhe veshjes me PVC dhe përcaktimi i agregateve dhe nyjeve jofunksionale
3. Hartimi i projekteve të ndërhyrjes dhe zëvendësimit të agregateve jo funksionale 200 000 USD

Periudha nga 6 deri në 12 muaj

1. Rikonstruksioni i ndërtesave, dyer, dritare, ndriçim, hidroizolimi dhe sistem ajrimi
2. Montimi i agregateve dhe nyjeve të reja në linjat e telëzimit dhe i veshjes me PVC
3. Montimi dhe instalimi i sistemeve të reja të lëshimit dhe komandimit të makinerive 200 000 USD

Periudha nga 12 deri në 24 muaj

1. Rikonstruksioni i laboratorit dhe pajisja me aparatura të reja të matjeve dhe kontrollit të cilësisë dhe standardit
2. Montimi rendor i sistemit elektronik të kontrollit të procesit dhe të cilësisë së produktit në telëzim dhe veshje me senor për kontroll kompjuterik 600 000 USD

Faza e dytë

Periudha nga 24 deri në 30 muaj

1. Rikonstruksioni i infrastrukturës së furnizimit me ujë, me energji, me karburant etj. Për linjën e derdhjes së pandërprerë
2. Rikonstruksioni sipas projektit i ndërtesave që do të përshtaten për linjën e derdhjes së pandërprerë tip otokumpu 800 000 USD

Periudha nga 30 deri në 48 muaj

- Importimi dhe montimi i linjës së derdhjes së pandërprerë, specializimi i personelit dhe vënia e linjës në punë sipas projektit 4 700 000 USD

Faza e tretë

Periudha nga 48 deri në 60 muaj

- Importimi dhe montimi i makinerive të reja për prodhimin e të gjithë nomenklaturës - Tela të veshur të seksioneve të ndryshme

- Tela të zmaltuar të seksioneve të ndryshme
 - Litarë linjash ajrore bakri dhe alumini
 - Kabllo fuqie, komandimi, sinjalizimi ndërlidhjeje etj.
- Shuma totale e investimeve do të jetë:

4 500 000 USD
10 000 000 USD

Ky program investimesh do të fillojë të zbatohet pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, në përputhje me kriteret specifike të punimeve të përcaktuara në nenin 3 (tre) të kësaj marrëveshjeje. Në varësi të kërkesave të tregut vendor dhe për eksport prodhimi do të orientohet për të plotësuar standardet e BE-së për të gjitha kabllo të fuqisë, ndërlidhjes, sinjalizimit dhe për të gjithë telat e zhveshur, të veshur dhe të zmaltuar. Për këtë do të rikonstruktohen edhe repartet ndihmëse të drurit, të plastikës, ofiçina etj.

Rikonstruksioni i reparteve ndihmëse do të bëhet i ndërthurur në kohë me fazat e investimeve.


ANEKSI NR.3

LISTA EMËRORE E PUNONJËSVE TË UZINËS SË TELAVE E KABKLLLOVE, SHKODËR

- | | |
|---------------------|-----------------------|
| 1. Agron Çuliqi | 26. Selami Zhega |
| 2. Pal Voci | 27. Maksim Themollari |
| 3. Ixhlal Cani | 28. Rasim Çuka |
| 4. Lejla Mandia | 29. Fatmir Gërçari |
| 5. Majlinda Nuhi | 30. Valentina Sala |
| 6. Lejla Galica | 31. Irfan Draçini |
| 7. Vaid Luli | 32. Mit'hat Trashani |
| 8. Myrvet Lopçi | 33. Shemsije Keraç |
| 9. Bajram Fiku | 34. Shpëtim Dini |
| 10. Çezar Dërguti | 35. Dilaver Jahja |
| 11. Zija Paçrami | 36. Nikolina Marashi |
| 12. Qemal Çela | 37. Fran Kroni |
| 13. Shyqyri Kukiqi | 38. Agron Përkola |
| 14. Bardhyl Beshiri | 39. Altin Pepmarku |
| 15. Alush Mujani | 40. Vuksan Leka |
| 16. Adnan Kotrri | 41. Vitor Gjellaj |
| 17. Myzafer Kraja | 42. Simon Gjergji |
| 18. Bujar Llolla | 43. Ejll Marku |
| 19. Njoftim Gërçari | 44. Benjamin Thaçi |
| 20. Sabri Pema | 45. Mustaf Kapici |
| 21. Ardian Kola | 46. Skënder Semina |
| 22. Pashko Daka | 47. Dervish Ademi |
| 23. Fatri Gradeci | 48. Mysteak Xhaferi |
| 24. Njazi Baci | 49. Sandër Paloka |
| 25. Ali Murrizi | 50. Fabian Kiri |

Shënim. Kjo listë mbyllet me numër rendor 50 (pesëdhjetë).

SHKALLA 1:2000



VENDIM
Nr.563, datë 27.8.2004

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.170, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË KUSHTEVE PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT E NËNPRODUKTEVE TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 16, 19, 20, 21 e 25 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", ndryshuar me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.170, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja "b" e paragrafit të parë të kreut I, riformulohet si më poshtë vijon:
"b. Leje e llojit "B", që u jepet shoqërive për tregtimin e gazit të lëngshëm të naftës dhe mbushjen e bombolave me këtë nënprodukt.".
2. Në pikën 2 të kreut I, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:
 - a) në fund të shkronjës "ç" shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
"Për lejet e llojit "B" projekti teknologjik i depove dhe i linjave duhet të jetë i miratuar edhe nga organet përkatëse të kontrollit të pajisjeve nën presion.";
 - b) pas shkronjës "ë" shtohet shkronja "f" me këtë përmbajtje:
"f. Leja mjedisore, sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin.".
3. Paragrafi i parë i kreut II, ndryshohet si më poshtë vijon:
"Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjete dhe vajrave lubrifikante, bëhet nga:
 - a) ministri që mbulon veprimtarinë e transportit rrugor, kur stacioni është ndërtuar në autostradë;
 - b) organet e qeverisjes vendore për kategoritë e tjera të rrugëve dhe për raste të tjera.".
4. Në pikën 1 të kreut II, të bëhet ky ndryshim dhe kjo shtesë:
 - a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë vijon:
"1. Për marrjen e autorizimeve për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjete dhe vajrave lubrifikante, subjekti duhet të paraqesë pranë organit që ka të drejtën e dhënies së autorizimit këto dokumente.".
 - b) Në fund të shkronjës "c" shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:
"Projekti teknologjik për depot dhe linjat që përdoren për depozitim dhe shitjen e gazit të lëngshëm të naftës, duhet të jetë i miratuar nga Inspektorati i Pajisjeve nën Presion.".
5. Pika 6 e kreut II, ndryshohet si më poshtë vijon:
"6. Dhënia e autorizimeve për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit të lëngshëm të naftës, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit për përdorim rezidencial bëhet nga organet e qeverisjes vendore.
Subjekti, që kërkon të pajiset me autorizimin për shitjen e lëndëve djegëse dhe të bombolave të gazit të lëngshëm të naftës, duhet të paraqesë këto dokumente:
 - a) Vërtetimin për pronësinë apo kontratën e marrjes në përdorim të mjedisit përkatës;
 - b) Certifikatën e kalibrimit të enëve dhe të aparateve të shitjes, të lëshuar nga organet e metrologjisë e të kalibrimit në njësitë e qeverisjes vendore;
 - c) Vërtetimin e lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe të nënprodukteve të tyre, për respektimin e kushteve dhe të rregullave teknike për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe të bombolave të gazit të lëngshëm të naftës.

Kur njësitë e shitjes së lëndëve djegëse tregtojnë bombola gazi të lëngshëm të naftës, duhet të paraqesin edhe vërtetimin nga Inspektorati i Pajisjeve nën Presion."

6. Pikat 4 dhe 5 të kreut III "Pagesat", ndryshohen si më poshtë vijon:

"4. Për autorizimet për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjete dhe vajrave lubrifikante 100 000 lekë

5. Për autorizimet për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit të lëngshëm të naftës 50 000 lekë."

7. Paragrafi i fundit i kreut III, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Të ardhurat, që realizohen nga pagesat e tarifave për pikat 4 dhe 5 të kreut III, të përdoren nga organi i pushtetit vendor që i jep autorizimin, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi."

8. Pas paragrafit të fundit, të kreut III, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"10 për qind e të ardhurave të përfituara nga gjobat e vendosura nga strukturat e ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet në zbatim të nenit 13 të ligjit nr.9218, datë 8.4.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", me miratimin e ministrit, të përdoren vetëm për blerje të pajisjeve dhe të aparaturave, për rritjen cilësore të punës në këtë sektor, si dhe për publikime, kualifikime e specializime brenda dhe jashtë vendit."

9. Në pikën 1 të kreut V, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Kushtet dhe rregullat teknike për përpunimin e bombolave të gazit të lëngshëm të naftës, në njësitë e tregtimit me pakicë të tyre, përgatiten nga organizmat dhe institucionet në përbërje ose varësi të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet dhe miratohen nga ministri që mbulon veprimtarinë hidrokarbure."

10. Kreu VI shfuqizohet.

11. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.564, datë 27.8.2004

PËR VLERËSIMIN E AUTOMJETEVE TË PARKUT TË TRANSPORTIT TË MINERALIT, BULQIZË DHE TË AUTOMJETEVE TË UZINËS SË FERROKROMIT, BURREL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlerësimin e automjeteve të parkut të transportit të mineralit, Bulqizë dhe i automjeteve të uzinës së ferrokromit, Burrel, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kryhet nga një grup ekspertësh të caktuar nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, të cilët të llogarisin vlerën reale sipas gjykimit teknik të gjendjes faktike të tyre me çmimet e tregut aktual.

2. Për këtë proces vlerësimi nuk do të zbatohen përcaktimet e kapitullit I, të vendimit nr.159, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedurat e shitjes".

3. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E AUTOMJETEVE SH.A. ALBKROM (NE LIKUJDIM E SIPER)
QE DO TE TRAJTOHEN ME PROJEKTVENDIMIN E RI TE QEVERISE**

Nr.	Emertimi	Targa e Automjetit	Viti i prodhimit	Koha e blerjes	Data e hyrjes ne inventar	Vlera e Fatures dhe Kontabel	Data e miratimit per privatizim
1	Autobuz Viking Indian	BZ 0464 A	1991	1991	Nentor 1991	4,585,006	Nr.5261/6 dt 19.10.01
2	Autobuz Viking Indian	BZ 0430 A	1991	1991	Nentor 1991	4,585,006	"
3	Autobuz Viking Indian	BZ 0436 A	1991	1991	Nentor 1991	4,585,006	"
4	Autobuz Viking Indian	BZ 0456 A	1991	1991	Nentor 1991	4,585,006	"
5	Autobuz Viking Indian	BZ 0475 A	1991	1991	Nentor 1991	4,585,006	"
6	Kamion Liaz 150-261	BZ 0460 A	1991	1991	Dhjetor 1991	1,349,480	"
7	Kamion Liaz 150-261	BZ 0462 A	1991	1991	Dhjetor 1991	1,349,480	"
8	Kamion Liaz 150-261	BZ 0461 A	1991	1991	Dhjetor 1991	1,349,480	"
9	Kamion Liaz 150-261	BZ 0467 A	1991	1991	Dhjetor 1991	1,349,480	"
10	Kamion Reno CLM280	BZ 0454 A	1991	1992	Janar 1992	5,495,505	"
11	Kamion Reno CLM280	BZ 0415 A	1991	1992	Janar 1992	5,823,800	"
12	Kamion Reno CLM280	BZ 0421 A	1991	1992	Janar 1992	5,495,505	"
13	Kamion Reno CLM280	BZ 0485 A	1991	1992	Janar 1992	5,823,800	"
14	Kamion Reno CLM280	BZ 0452 A	1991	1992	Janar 1992	5,495,505	"
15	Kamion Reno CLM280	BZ 0449 A	1991	1992	Janar 1992	5,823,800	"
16	Kamion Reno CLM280	BZ 0455 A	1991	1992	Janar 1992	5,495,505	"
17	Kamion Reno CLM280	BZ 0451 A	1991	1992	Janar 1992	5,495,505	"
18	Kamion LIAZ 150-261	LA 1471 A	1991	1991	Dhjetor 1991	1,349,480	Nr.151/2 dt. 16.02.01
19	KamionRenaulCLM280	KU 0853 A	1991	1992	Janar 1992	5,625,800	Nr.3079/1 dt 09.09.02
20	Autobuz Iveko 135-17	BZ 0275 A	1992	1992	Gusht 1992	15,170,625	Nr.5261/6 dt.19.10.01
21	Autobuz Iveko 135-17	BZ 0443 A	1992	1992	Gusht 1992	15,170,625	"
22	Autobuz Iveko 135-17	BZ 0482 A	1992	1992	Gusht 1992	15,170,625	"
23	Autobuz Iveko 135-17	MT 0504 A	1992	1993	Gusht 1993	15,170,625	Nr.2343/1 dt 23.04.04
24	Kamion Iveko 190-30H	BZ 0922 A	1992	1996	Korrik 1996	8,395,073	Nr.5261/6 dt.19.10.01
25	Kamion Iveko 190-30H	BZ 0444 A	1992	1994	Mars 1994	9,450,881	"
26	Kamion Iveko 190-30H	BZ 0480 A	1992	1994	Mars 1994	9,450,881	"
27	Kamion Iveko 190-30H	BZ 0066 A	1992	1996	Maj 1996	8,395,037	"
28	Kamion Iveko 330-30H	BZ 0442 A	1992	1993	Mars 1993	10,894,639	"
29	Kamion Iveko 330-30H	BZ 0425 A	1992	1993	Mars 1993	10,894,639	"
30	Kamion Iveko 330-30H	BZ 0418 A	1992	1993	Mars 1993	10,894,639	"
31	Kamion Iveko 330-30H	BZ 0431 A	1992	1993	Mars 1993	10,894,634	"
32	Kamion Iveko 330-30H	BZ 0427 A	1992	1993	Mars 1993	10,894,634	"
33	Kamion Iveko 330-30H	TR 2953 B	1992	1993	Mars 1993	10,894,634	"
34	Kamion Iveko 330-30H	BZ 0426 A	1992	1993	Mars 1993	10,894,634	"
35	Kamion Iveko 190-30H	BZ 0251 A	1992	1996	Qershor 1996	8,615,573	Nr. 183/1 dt 22.01.02
36	Kamion Liaz 150-261	BZ 0437 A	1992	1992	Gusht 1992	1,349,480	Nr.5261/6 dt.19.10.01
37	Kamion Liaz 150-261	BZ 0445 A	1992	1992	Gusht 1992	2,295,000	"
38	Kamion Liaz 150-261	BZ 0435 A	1992	1992	Gusht 1992	2,295,000	"
39	Kamion Iveko 190-30H	MT 0181 A	1992	1993	Prill 1993	9,451,000	Nr.3622/2 dt.1.08.00
40	Kamion Iveko 190-30H	MT 0180 A	1992	1993	Prill 1993	9,825,000	"
41	Kamion Iveko 190-30H	MT 0872 A	1992	1995	Mars 1995	9,640,000	"
42	Kamion Iveko 190-30H	MT 0179 A	1992	1993	Prill 1993	9,451,000	"

43	Kamion Iveko190-30H	MT 0198 A	1992	1994	Maj 1994	9,451,000	Nr.151/2 dt 16.02.01
44	Kamion Iveco 190-30H	MT 0260 A	1992	1994	Maj 1994	9,400,000	Nr.3622/2 dt.01.08.00
45	Kamion Iveko 190-30H	MT 0537 A	1992	1994	Nentor 1994	9,740,000	Nr. 151/2 dt.16.02.01
46	Kamion Iveko 190-30H	MT 0259 A	1992	1994	Maj 1994	9,400,000	"
47	Kamion Iveko 190-30H	DR 1038 A	1992	1993	Qershor1993	9,450,881	Nr.3079/1 dt 9.09.02
48	Kamion Reno CLM280	MT 0342 A	1991	1992	Gusht 1992	5,800,000	Nr.3622/2 dt 01.08.00
49	Kamion Reno CLM280	MT 0226 A	1991	1992	Gusht 1992	3,500,000	Nr.151/2 dt 16.02.01
50	Kamion Reno CLM280	MT 0332 A	1991	1992	Gusht 1992	5,800,000	"
51	Kamion Reno CLM280	MT 0182 A	1991	1992	Gusht 1992	3,500,000	"
52	Kamion Reno CLM280	MT 0262 A	1991	1992	Gusht 1992	5,800,000	Nr.3622/2 dt 1.08.00
53	Kamion Reno CLM280	MT 0261A	1991	1992	Gusht 1992	5,800,000	"

VENDIM
Nr.567, datë 27.8.2004

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE
JOPUBLIKE "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1,12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë", sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin nr.156, datë 22.3.2001 të Këshillit të Ministrave "Për shkollat e larta jopublike në Republikën e Shqipërisë".

2. Shkolla e lartë universitare jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë" me seli qendrore në Tiranë, me adresë: Rruga e Durrësit, kompleksi universitar spitalor "Zoja e Këshillit të Mirë" do të ketë këto fakultete:

- Fakultetin e Mjekësisë;
- Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Politike;
- Fakultetin e Shkencave të Aplikuara.

3. Shkolla e lartë universitare jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë" jep:

a) Diploma universitare në:

- Ekonomi dhe administrim ndërmarrjeje (3 vite akademike);
- Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare (3 vite akademike);
- Inxhinieri informatike (3 vite akademike);
- Infermieristikë (3 vite akademike);
- Fizioterapi (3 vite akademike).

b) Diploma universitare të specialitetit në:

- Mjekësi (6 vite akademike);
- Odontoiatri dhe proteza dentare (5 vite akademike);
- Farmaci dhe farmaci industriale (5 vite akademike);
- Arkitekturë (5 vite akademike).

c) Diploma specialiteti në:

- Administrim shëndetësor (2 vite akademike pas diplomës universitare);
- Studime europiane (2 vite akademike pas diplomës universitare);
- Inxhinieri informatike (2 vite akademike pas diplomës universitare);
- Infermieristikë (1-2 vite akademike pas diplomës universitare);

- Fizioterapi (1-2 vite akademike pas diplomës universitare).
 - ç) Diploma të specializimit në:
 - Mjekësi (3-5 vite akademike, pas diplomës universitare të specialitetit);
 - 4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe akreditimit të kurseve të studimit dhe të zbatimit të legjislacionit në këtë fushë.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.570, datë 27.8.2004

**PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA PARCELAVE
PYJORE, PJESË TË EKONOMISË PYJORE GJADËR-MNELË, SHKODËR, NGA
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE E USHQIMIT, MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
"PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe të nenit 7 të ligjit nr.7623, datë 13.10.1992 "Për pyjet dhe Policinë e Shërbimit Pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Parcelat pyjore me numrat rendorë 13-23, përfshirë edhe këta numra, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 351,64 ha, pjesë të ekonomisë pyjore Gjadër-Mnelë, Shkodër, kalojnë në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit te Ministria e Mbrojtjes, për t'u përdorur për ngritjen e kazermës ushtarake nr.1101, në komunën e Vaut të Dejës, Shkodër.

2. Parcelat pyjore të përcaktuara në pikën 1 të përfshihen në pronën nr.392, me emërtimin "Reparti ushtarak nr.1130", komuna e Vaut të Dejës, Shkodër", të listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**PARCELAT E EKONOMISË PYJORE GJADËR MNELE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES**

Nr.	Nr.Invent.	Nr.faqes	Nr.parcelës	Sip.ha	Destinacioni	Vërejtje
1	3211	102	13/a	21.55	Pyll prodh	Në administrim të DPPK Tiranë
2	3212	102	13/b	8.00	Pyll prodh	"
3	3213	102	14/a	9.75	Pyll prodh	"
4	3214	102	14/b	17.08	Pyll prodh	"
5	3215	102	15/a	5.75	Pyll prodh	"
6	3216	102	15/b	4.50	Pyll prodh	"
7	3217	102	16/a	9.50	Pyll prodh	"
8	3218	102	16/b	17.58	Pyll prodh	"
9	3219	102	16/c	10.75	Pyll prodh	"
10	3220	102	17	26.6	Pyll prodh	"
11	3221	102	18	32.35	Pyll prodh	"
12	3222	102	19/a	19.85	Pyll prodh	"
13	3223	102	19/b	16.08	Pyll prodh	"
14	3224	102	20	44.95	Pyll prodh	"
15	3225	102	21	31.85	Pyll prodh	"
16	3226	102	22	40.70	Pyll prodh	"
17	3295	105	23	34.80	Pyll prodh	"

**VENDIM
Nr.571, datë 27.8.2004**

**PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË AKADEMINË E
POLICISË "ARBEN ZYLYFTARI", PËR VITIN AKADEMIK 2004-2005**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e pranimit në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari", për vitin akademik 2004-2005, të jetë 50 (pesëdhjetë) studentë.
2. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

VENDIM
Nr.573, datë 27.8.2004

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MALIT TË ZI,
PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE TË
MALLRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Malit të Zi, për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
TË MALIT TË ZI MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE
MALLRAVE**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Malit të Zi, referuar këtu e më poshtë si Palët Kontraktuese,

me dëshirën për të kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike ndërmjet vendeve të tyre;

të vendosur për të nxitur bashkëpunimin në transportin ndërkombëtar brenda kuadrit të ekonomisë së tregut;

të interesuar për mbrojtjen e mjedisit dhe të njerëzve, përdorimin racional të energjisë, sigurinë rrugore dhe përmirësimin e kushteve të punës së shoferëve;

duke synuar drejt zhvillimit të intermodalitetit të transportit;

duke njohur interesin dhe avantazhet e përbashkëta të një marrëveshjeje mbi transportin ndërkombëtar rrugor;

ranë dakord dhe vendosën si më poshtë:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i zbatimit

Marrëveshja në fjalë rregullon transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave të kryer nga operatorët e transportit të vendosur në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese me anë të mjeteve të regjistruara në atë territor, me pikë të nisjes dhe destinacion në territorin në fjalë dhe duke përfshirë transitin nëpërmjet atij territori ose nëpërmjet territorit të shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

Kjo Marrëveshje nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga angazhimet e tjera ndërkombëtare të të dyja Palëve Kontraktuese, as nuk ndikon në rregullat e Bashkimit Europian dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Europian dhe vendeve joanëtare.

Neni 2 Përkufizime

Në këtë Marrëveshje:

“Operator transporti” nënkupton çdo person juridik ose fizik të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë ose çdo person juridik të vendosur në territorin e Republikës së Malit të Zi të regjistruar në përputhje me rregullat në fuqi, për të kryer operime të transportit ndërkombëtar rrugor.

“Mjet” nënkupton një mjet motorik të regjistruar në territorin e shtetit të njëres prej Palëve Kontraktuese dhe në sajë të ndërtimit dhe pajisjeve e tij me qëllim transportin ndërkombëtar të pasagjerëve dhe të mallrave.

“Transport” nënkupton operimet e një mjeti i ngarkuar ose jo i ngarkuar edhe nëse mjeti, traileri ose semi-traileri transportohet me tren ose anije për pjesë të udhëtimit.

“Kabotazh” nënkupton transportin e pasagjerëve ose mallrave të kryer nga një operator transporti i një Pale Kontraktuese nëpërmjet vendeve të veçanta brenda territorit të Palës tjetër Kontraktuese.

“Transport i kombinuar” nënkupton transportin e mallrave përmes të cilit kamioni, traileri, semi-traileri, *swap body* ose kontenieri, me ose pa traktor, përdorin rrugën për pjesë të nisjes ose të mbërritjes të udhëtimit, e cila është sa më e shkurtër të jetë e mundur, dhe udhëtojnë me hekurudhë autostradë ose det për pjesën më të madhe të udhëtimit.

“Territori i një Pale Kontraktuese” nënkupton përkatësisht territorin e Republikës së Shqipërisë dhe territorin e Republikës së Malit të Zi.

“Vendi i vendosjes” nënkupton territorin e Palës Kontraktuese brenda së cilës operatori i transportit është vendosur dhe në të cilin mjeti është regjistruar.

“Vendi pritës” nënkupton territorin e një Pale Kontraktuese në të cilin operatori i transportit operon pa mjetin e tij të regjistruar atje dhe pa operator transporti të vendosur atje.

“Autobus” nënkupton një mjet të regjistruar në territorin e një prej Palëve Kontraktuese dhe në sajë të ndërtimit dhe pajisjeve të përshtatshme dhe me qëllim transportin e pasagjerëve dhe që ka përveç sediljes së shoferit, më shumë se tetë sedilje.

“Shërbim i rregullt i udhëtarëve” nënkupton një shërbim që kryen transportin e udhëtarëve për një rrugë të caktuar, sipas një orari dhe listë çmimesh të vendosura dhe të publikuara më parë. Shërbimi i rregullt i udhëtarëve është caktuar për këdo sipas të njëjtave kushteve, me udhëtarë që merren dhe lihen në ndalesat e paracaktuara.

Në veçanti, ai përfshin një shërbim i cili transporton kategori të veçanta udhëtarësh me përjashtim të udhëtarëve të tjerë. Ky shërbim quhet një “shërbim special i rregullt”. Shërbimi si një shërbim i rregullt nuk ndikohet nga fakti që transporti organizohet në përshtatje me nevojat e ndryshme të përdoruesve.

“Shërbim vajtje-ardhje” nënkupton një shërbim me anë të të cilit, nëpërmjet udhëtimeve të përsëritura vajtje-ardhje, grupe udhëtarësh të formuara më parë transportohen nga një vend i vetëm nisjeje në një destinacion të vetëm. Secili grup përbëhet nga udhëtarë të cilët udhëtojnë së bashku dhe kthehen në vendin e nisjes në një udhëtim të mëvonshëm. Vendi i nisjes dhe vendi i mbërritjes respektivisht nënkuptojnë vendin ku fillon udhëtimi dhe vendin ku mbaron udhëtimi, së bashku me, në secilin rast, lokalitetin rrethues në një rreze prej 50 km.

Një shërbim vajtje-ardhje mund të përfshijë akomodimin e udhëtarëve në destinacionin e tij dhe po qe nevoja gjatë udhëtimit.

Udhëtimi i parë i kthimit dhe udhëtimi i fundit i nisjes në një seri shërbimesh vajtje-ardhje janë bosh.

“Shërbimi i rastit” nënkupton një shërbim që nuk futet as në përkufizimin e shërbimit të rregullt të udhëtarëve as në përkufizimin e shërbimit vajtje-ardhje. Shpeshësia ose numri i shërbimeve nuk ndikojnë në klasifikimin e tyre si një shërbim i rastit.

“Dokumentet e kontrollit” nënkupton dokumentet e lëshuara sipas kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese dhe atyre të vendosura nga komiteti i përbashkët sipas nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje. Këto dokumente duhet të jenë në mjet dhe të paraqiten kur kërkohet nga autoritetet kompetente të kontrollit të të dyja Palëve Kontraktuese.

TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 3

Shërbimet e rregullta të udhëtarëve

Shërbimet e rregullta të udhëtarëve që kryhen me autobus i nënshtrohen një sistemi autorizimesh të lëshuara nga autoriteti kompetent në vendin e nisjes, destinacionit dhe transitit.

Aplikimi i autorizimit bëhet pranë autoritetit kompetent në vendin e vendosjes së operatorit të transportit. Nëse autoriteti kompetent i vendit të vendosjes aprovon aplikimin, autorizimi i komunikohet autoritetit kompetent të vendit pritës.

Komiteti i përbashkët i ngritur sipas nenit 14 që këtë vendos për formën e aplikimit për autorizim dhe dokumentet shoqëruese që kërkohen, gjithashtu për kushtet e mjedisit, të sigurisë dhe kushte të tjera për lëshimin e një autorizimi.

Autorizimi referuar në paragrafin e parë të këtij neni lëshohet me marrëveshje të përbashkët të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese.

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese lëshojnë autorizimin e referuar në paragrafin e parë të këtij neni brenda një periudhe tremujore nga dita e marrjes së aplikimit për autorizim nga autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese. Ky afat mund të ndryshojë në rast rrethanash të paparashikuara, për të cilat autoritetet kompetente mbajnë të informuar njëra-tjetrën.

Autorizimi i referuar në paragrafin e parë të këtij neni është i vlefshëm për maksimumi pesë vjet. Ai detajon kushtet e operimit për kryerjen e shërbimeve të rregullta të udhëtarëve.

Ndryshimet në kushtet e operimit dhe anulimi i shërbimit vendosen sipas procedurave të detajuara në paragrafin e dytë dhe të tretë të këtij neni.

Neni 4

Shërbimet e rastit dhe ato vajtje-ardhje

Shërbimet e rastit dhe shërbimet vajtje-ardhje që kryhen me autobus i nënshtrohen një sistemi autorizimesh ose lejesh të lëshuara nga autoriteti kompetent në vendin e nisjes, destinacionit dhe transitit. Si një përjashtim nga dispozitat e paragrafit të parë të këtij neni, shërbimet e listuara më poshtë përjashtohen nga çdo sistem autorizimesh ose lejesh në territorin e vendit pritës.

Udhëtimet vajtje-ardhje përmes të cilave i njëjti autobus përdoret për të transportuar të njëjtin grup udhëtarësh gjatë gjithë udhëtimit dhe t'i sjellë ata përsëri në vendin e nisjes, në vendin ku operatori i transportit vendoset.

Shërbimet që transportojnë udhëtarë nga vendi i nisjes në territorin e vendosjes së operatorit të transportit në destinacion dhe duke e bërë udhëtimin në kthim bosh.

Shërbimet të cilat e bëjnë udhëtimin në vajtje bosh dhe udhëtimin në kthim plot me kusht që:

Udhëtarët të jenë sjellë më parë nga i njëjti transportues në territorin e vendit pritës ku ata merren përsëri dhe transportohen në territorin e vendit të vendosjes.

Udhëtarët të jenë ftuar për të udhëtuar në territorin e vendit të vendosjes së operatorit të transportit me kosto transporti të siguruar nga personi që bën ftesën.

Udhëtarët të përbëjnë një grup të formuar më parë sipas një kontrate të transportimit të përfunduar përpara mbërritjes së tyre në territorin e Palës Kontraktuese ku ata janë marrë.

Marrja dhe lënia e udhëtarëve gjatë udhëtimit të referuar në paragrafin e dytë të këtij neni nuk lejohet vetëm nëse jepet autorizim i veçantë nga autoriteti kompetent në vendin pritës.

Komiteti i përbashkët, i ngritur sipas nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje, mund të japë autorizimin ose lejen e shkarkimit dhe kategorive të tjera të shërbimeve të rastit dhe shërbimeve vajtje-ardhje.

Aplikimi i autorizimit ose i lejes referuar në paragrafin e parë të këtij neni duhet të bëhet nga autoriteti kompetent në vendin e vendosjes së operatorit të transportit. Nëse autoriteti kompetent i vendit të vendosjes aprovon aplikimin, aplikimi i komunikohet autoritetit kompetent të vendit pritës.

Komiteti i përbashkët, i ngritur sipas nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje, vendos mbi formën që merr aplikimi për autorizim ose leje dhe dokumentet shoqëruese që kërkohen.

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese lëshojnë autorizimin e referuar në paragrafin e parë të këtij neni brenda një periudhe prej një muaji nga data e dorëzimit të aplikimit nga autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese. Ky afat mund të ndryshojë në rast rrethanash të paparashikuara, për të cilat autoritetet kompetente informojnë njëra-tjetrën.

Ndërsa kryhen shërbimet e referuara në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, operatorit të transportit i kërkohet të mbajë një dokument kontrolli në mjet, për transportin e referuar në paragrafin e dytë sipas pikës 3 (c). Është e nevojshme të ketë gjithashtu kontratën në mjet dhe, për transportin e referuar në paragrafin e dytë sipas pikës 3(b), në mjet, është e nevojshme të ketë dhe ftesën. Kushtet e përdorimit dhe përmbajtja e dokumentit të kontrollit vihen nga Komiteti i përbashkët i referuar në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje.

Për zëvendësimin e një autobusi të prishur nuk kërkohet leje.

Neni 5

Dispozita të përbashkëta për shërbimet e udhëtarëve

Autorizimet e transportit dhe lejet e referuara në nenet 3 dhe 4 nuk u transferohen operatorëve të tjerë të transportit.

Ndalohet kryerja e shërbimeve të kabotazhit. Udhëtimet lokale të organizuara vetëm për një grup udhëtarësh të sjellë në atë vend nga i njëjti operator transporti nuk konsiderohen shërbime të kabotazhit, me kusht që ato të futen në dokumentin e kontrollit.

TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 6

Sistemi i lejeve

Operatorët e transportit të regjistruar në territorin e një Pale Kontraktuese mund të kryejnë sipas sistemit të lejeve, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese:

- transport ndërmjet territoreve të të dyja Palëve Kontraktuese;
- transport transit ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese;
- transport ndërmjet një pike në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe një pike në territorin e një shteti të tretë dhe anasjelltas.

Kabotazhi lejohet vetëm me autorizimin special të vendit pritës.

Neni 7

Transporti i përjashtuar nga kërkesat për leje

Si një përjashtim nga dispozitat e nenit 6, kategoritë e mëposhtme të transportit, janë të përjashtuara nga kërkesat për leje:

Transporti me mjete për të cilat pesha totale e lejueshme e ngarkesës, duke përfshirë trailerat nuk i kalon 6 tonët ose kur pesha e lejuar, duke përfshirë trailerat, nuk i kalon 3.5 tonët;

Transporti i rastit për në ose nga aeroportet në rastet kur shërbimet ajrore ndryshojnë drejtim;

Transporti i mjeteve të cilat janë dëmtuar ose janë prishur dhe transporti i mjeteve që duhet të riparohen;

Udhëtimet bosh të një mjeti mallrash të dërguar për të zëvendësuar një mjet mallrash, i cili është dëmtuar në vendin tjetër, gjithashtu edhe udhëtimi i kthimit mbas riparimit të mjetit që është dëmtuar;

Transporti i pjesëve të ndërrimit dhe rezervave për avionët dhe anijet transoqeanike;

Transporti i furnizimeve mjekësore dhe pajisjeve të nevojshme për emergjenca, veçanërisht në rast katastrofash natyrore dhe nevojash humanitare;

Transporti i punimeve dhe objekteve të artit për panairë dhe ekspozita ose për qëllime jotregtare;

Transporti për qëllime jotregtare i pasurive, aksesorëve dhe kafshëve për ose nga shfaqje teatrale, muzikore, filmike, sportive ose cirku, panairë ose festivale dhe pajisjet që kërkohen urgjentisht për regjistrime në radio, prodhime filmike ose televizive;

Zhvendosjet e kryera nga pajisje dhe stafe të caktuara.

Transporti funeral:

Pjesa fillestare dhe përfundimtare-ndërkombëtare dhe kombëtare-me rrugë e transportit të kombinuar, duke siguruar, respektivisht që të përdoret stacioni i përshtatshëm i ngarkimit ose shkarkimit të ngarkesës më i afërti me pikën e ngarkimit ose shkarkimit të ngarkesës.

Transporti i postës:

Në lidhje me operacionet e transportit referuar në këtë nen, shoferi duhet të mbajë të gjitha letrat dhe dokumentet që tregojnë qartësisht se është rasti i një prej llojeve të mësipërme të transportit.

Komiteti i përbashkët, referuar nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje me marrëveshje të përbashkët të shtojë ose të heqë nga, listën e kategorive të transportit referuar në paragrafin e parë të këtij neni mund të përjashtohen nga kërkesat për leje.

Neni 8

Dispozita të përbashkëta për transportin e mallrave

Autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese shkëmbejnë një numër të rënë dakord ekzemplarë lejesh bosh çdo vit.

Lejet për transportin e mallrave janë të vlefshme për 13 muaj nga fillimi i secilit vit kalendarik.

Leja e referuar në paragrafin e parë të këtij neni nuk është e transferueshme.

Leja mund të përdoret vetëm për një mjet për një herë. Në rast të kombinimeve të mjeteve, mjeti motorik është faktori përcaktues në lëshimin ose përjashtimin e lejes.

Komiteti i përbashkët, i referuar në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje, vendos kuotën, kategorinë, kushtet e lëshimit dhe përdorimin e ekzemplarëve të lejeve bosh, po ashtu dhe kushtet sipas të cilave kategori të veçanta të transportit mund të përjashtohen nga sistemi i lejeve.

Ndalohet kryerja e shërbimeve të kabotazhit, përveç kur autorizohet në veçanti nga autoriteti kompetent i vendit pritës.

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 9

Taksat

Lënda djegëse që ndodhet normalisht në depozitën e karburantit të mjetit të fiksuar të ndërtuar nga prodhuesi me qëllim drejtimin e mjetit, gjithashtu lubrifikantët dhe pjesët e ndërrimit përjashtohen nga të gjitha taksat/detyrimet e importit në territorin e vendit pritës, me kusht që operatori i transportit u përputhet rregullave doganore përkatëse.

Transporti ndërkombëtar i pasagjerëve dhe mallrave me rrugë, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohet në vendin pritës taksave, tarifave dhe detyrimeve të tjera për përdoruesit e rrugës të vëna për përdorimin e rrugës në vendin pritës në përputhje me rregullat në fuqi.

Komiteti i përbashkët i referuar në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje mund të gjykojë dhe t'u propozojë autoriteteve kompetente përjashtimin e pjesshëm ose të plotë, mbi baza reciprociteti nga pagesat e taksave nga një operator transporti në lidhje me kryerjen e shërbimeve të transportit.

Neni 10

Pesha dhe përmasat e mjeteve

Pesha maksimale e lejuar, pesha e aksit dhe përmasat e mjetit nuk duhet të kalojnë ato që janë në dokumentet e regjistrimit, as limitet më të larta në fuqi në vendin pritës.

Përdorimi në vendin pritës i mjeteve, pesha dhe përmasat e të cilave kalojnë limitet më të larta të lejuara, lejohet vetëm me një autorizim të veçantë të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit pritës dhe për të cilin është aplikuar më parë.

Neni 11

Pajisjet dhe karakteristikat e tjera të mjeteve

Mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme ose që prishen shpejt duhet të sigurohen dhe të pajisen në përputhje me rregullat ndërkombëtare.

Çdo mjet i Palës Kontraktuese që kryen transport bilateral, transit ose me vende të treta në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe që transporton mallra të rrezikshme ose që prishen shpejt duhet të mbajë të gjitha dokumentet e parashikuara nga konventat ndërkombëtare respektive.

Pajisjet e përdorura për të monitoruar ekuipazhin e drejtimit dhe kohën e pushimit në mjet duhet të përputhen me rregullat ndërkombëtare.

Palët Kontraktuese marrin përsipër të nxisin, brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, përdorimin e mjeteve që plotësojnë standardet e sigurisë dhe të mjedisit.

Çdo mjeti të Palës Kontraktuese që kryen transport bilateral, transit ose me vende të treta në territorin e Palës tjetër Kontraktuese duhet t'i jepet një certifikatë të vlefshme të sigurisë rrugore nga një autoritet shtetëror.

Komiteti i përbashkët, i referuar në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje, kur vendoset për kuotat dhe liberalizimin e mundshëm në të ardhmen, mund t'i japë më shumë trajtime të favorshme mjeteve që plotësojnë më shumë standardet moderne të sigurisë dhe të mjedisit.

Neni 12

Kontrolli

Lejet dhe të gjitha dokumentet e tjera të parashikuara sipas marrëveshjeve multilaterale ose bilaterale, ose sipas ligjit kombëtar, duhet të mbahen në mjete dhe të paraqiten me kërkesën e autoriteteve kompetente të vendit pritës.

Neni 13

Detyrimet e operatorëve të transportit dhe shkeljet

Operatorët e transportit të një Pale Kontraktuese dhe ekuipazhi i mjeteve të tyre, kur janë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duhet të përputhen me ligjet dhe rregullat në fuqi të vendit pritës.

Në rast të ndonjë shkeljeje në vendin pritës të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga një operator i transportit, autoriteti kompetent i vendit pritës njofton autoritetin kompetent të vendit të vendosjes me qëllim që ky i fundit të marrë hapat e nevojshme ndaj operatorit të transportit, siç parashikohet nga legjislacioni i tij kombëtar.

Palët Kontraktuese mbajnë të informuara njëra-tjetrën për sanksionet e vëna.

Dispozitat e paragrafëve të parë dhe të dytë të këtij neni nuk përjashtojnë masat e marra nga autoritetet kompetente juridike ose të tjera të vendit pritës.

Neni 14

Bashkëpunimi dhe komiteti i përbashkët

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të mbajnë të informuara njëra-tjetrën për çdo informacion të dobishëm dhe çdo ndryshim në ligjin kombëtar që ndikon në zbatimin e saj.

Autoritetet kompetente i ofrojnë njëra-tjetrës çdo asistencë tjetër të përbashkët me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Një komitet i përbashkët ngrihet nga Palët Kontraktuese me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe për të trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshjeje.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje dhe që nuk mund të zgjidhet nga negociata të drejtpërdrejta ose nëpërmjet kanaleve diplomatike me kërkesën e secilës Palë Kontraktuese i drejtohet një gjykate arbitrazhi.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Hyrja në fuqi dhe periudha e vlefshmërisë së Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi kur Palët Kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se procedurat për hyrjen e saj në fuqi në përputhje me legjislacionin kombëtar kanë përfunduar.

Kjo Marrëveshje zbatohet perkohësisht që nga data e firmosjes së saj.

Marrëveshja në fjalë lidhet për një vit. Ajo do të zgjatet më pas për një periudhë njëvjeçare vetëm nëse një Palë Kontraktuese njofton tjetrën për qëllimin e saj për të përfunduar Marrëveshjen tre muaj përpara datës së skadimit, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Në dëshminë e të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar siç duhet, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Podgoricë, më 2 korrik 2004 në dy origjinale secila në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, të gjithë tekstet, duke qenë autentikisht të barabartë.

Në rast mosmarrëveshjeje në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje teksti në gjuhën angleze mbizotëron.

VENDIM

Nr.256, datë 31.8.2004

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT

"DCN"

SUBJEKTIT: SHOQËRIA "DIGITAL CABLE NETWORK" sh.a.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe rregullores "Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll" të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit,

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "Digital Cable Network" sh.a., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Albert Minga

VENDIM
Nr.257, datë 31.8.2004

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
"INKUSAT"

SUBJEKTIT: Z.ARTAN ZHIVA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe rregullores "Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll" të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit,

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit, z.Artan Zhiva, me vendndodhje në qytetin e Pogradecit, licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Albert Minga

VENDIM
Nr.258, datë 31.8.2004

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
"HB-CATV"

SUBJEKTIT: Z.HAJRI HOXHA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe rregullores "Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll" të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit,

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit, Z.Hajri Hoxha, me vendndodhje në qytetin e Peshkopisë, licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Albert Minga

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E DREJTËSISË	400

Doli nga shtypi më 10.9.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë